



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada Government

Zyra e Kryeministrit

Kancelaria Premijera – Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore – Pravna Kancelarija – Legal Office

## OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

17.04.2024

Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, me datë 15 prill 2024, bazuar në nenin 7, nënparagrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe nenit 13, paragrafit 5 të Rregullores Nr. 13/2023 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, si dhe në pajtim me nenin 12, paragrafin 3 dhe 4, nënparagrafin 4.19 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për Fushat e Përgjegjësisë të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit *Projektligji për Ratifikimin e “Amendamentit nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016”*.

### 1. SUBJEKTI

**Opinion Ligjor për Përputhshmërinë e *Projektligji për Ratifikimin e “Amendamentit nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016”*, me *acquis* të BE-së.**

### 2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit për Opinion të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti final i *Projektligjit* në tre gjuhë (versioni i gjuhës shqipe, angleze, dhe asaj serbe);
- Deklarata e Përputhshmërisë (versioni i gjuhës shqipe, serbe dhe angleze);
- Memorandumi Shpjegues.

### 3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7, paragrafin 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 3, nënparagrafit 1.3, nenit 13, paragrafi 6, si dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30, paragrafit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, së Zyrës së Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, me datë 17 prill 2024, lëshon këtë:

**4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË**  
Kërkesa për Opinion Ligjor me *acquis* të BE-së është dërguar në formë elektronike me datën 15 prill 2024.

### 5. HYRJE

Kjo *Projektligj* bën ratifikimin e “Amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2016”.<sup>1</sup> Ky *Projektligj* ka gjithsej 3 nene si dhe Marrëveshja dhe shtojcat e saj janë pjesë integrale të këtij *Projektligji*.

### 6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT-AKTIT NORMATIV

Fushëveprimi i IPA është i rregulluar me *acquis* primare dhe sekondare. Dispozitat ligjore të së drejtës së BE-së të cilat përcaktojnë masa të bashkëpunimit ekonomik, financiar dhe teknik, duke

---

<sup>1</sup> Neni 1 i *Projektaktit*.

përfshirë mbështetje, në veçanti mbështetje financiare, me vendet e treta dhe BE-së janë të definuar në dispozitat e Nenit 212 të TFBE-së.<sup>2</sup> Dispozitat e Nenin 212 të TFBE-së përcaktojnë:

Kreu 2

Bashkëpunimi ekonomik , financiar dhe teknik me vendet e treta

Neni 212

(ish-neni 181a TKE)

1. Pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve dhe në veçanti nenet nga 208 deri në 211, Bashkimi realizon masa të bashkëpunimit ekonomik, financiar dhe teknik, duke përfshirë mbështetje, në veçanti mbështetje financiare, me vendet e treta që nuk janë vende në zhvillim. Masa të tilla janë në pajtim me politikën e Bashkimit për zhvillim dhe zhvillohen në kuadër të parimeve dhe objektivave të veprimit të jashtëm të Bashkimit. Veprimet e Bashkimit dhe ato të Shteteve Anëtare plotësojnë dhe përforcojnë njëra-tjetrën.
2. Parlamenti Evropian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legislative, miratojnë masat e nevojshme për zbatimin e paragrafit 1.
3. Brenda sferave përkatëse të kompetencës, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me vendet e treta dhe me organizatat kompetente ndërkombëtare. Organizimi i bashkëpunimit të Bashkimit mund të jetë objekt i marrëveshjeve midis Bashkimit dhe palëve të treta të interesuara.  
Nënparagrafi i parë nuk e cenon kompetencën e Shteteve Anëtare për të negociuar në organet ndërkombëtare dhe për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Gjithashtu, legjislacioni dytësor i së drejtës së BE-së që i referohet fushëveprimit të instrumentit të para-anëtarësimi është i përcaktuar Rregulloren (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III).<sup>3</sup> Kjo rregullore përcakton Instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) për

<sup>2</sup> Versioni i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian [Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union] i qasshëm përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/BN/TXT/PDF/?uri=CELEX:12012E/TXT&from=EN>.

<sup>3</sup> Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) [Regulation (EU) 2021/1529 of the European Parliament and of the Council

periudhën e kornizës financiar shumëvjeçare 2021-2027 (e njohur si MFF 2021-2027).<sup>4</sup> Nuk aplikohet transpozimi i rregullores, mirëpo, vendet përfituese nën këtë rregullore janë të obliguara të transpozojnë *acquis* të BE-së për realizimin e objektivave të IPA III.<sup>5</sup>

Në kuadër të MSA-së, dispozitat që i referohen asistencës financiare janë të përcaktuara si në vijim:

#### Titulli IX Bashkëpunimi Financiar

##### Neni 121

Për të arritur objektivat e kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me nenet 7, 122 dhe 123 dhe 125 Kosova mund të marrë asistencë financiare nga BE-ja në formë grantesh dhe huash, duke përfshirë huat nga Banka Evropiane e Investimeve. Ndihma financiare e BE-se kushtëzohet me përparimin e mëtutjeshëm në përmbushjen e kritereve politike të Kopenhagës. Duhet, po ashtu, të merret në konsideratë përmbushja e detyrimeve të Kosovës me këtë marrëveshje si dhe raportet vjetore të progresit për Kosovën. Ndihma financiare e BE-së, po ashtu, do t'i nënshtrohet kushtëzimeve të PSA-së, në veçanti sa i përket angazhimit të përfituesit për të kryer reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale. Ndihma financiare që i jepet Kosovës do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, prioritetive të pajtuara dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate si dhe masave të marra për të reformuar dhe për të ristrukturuar ekonominë.

##### Neni 122

Asistenca financiare, në formën grantesh, do të sigurohet në përputhje me rregulloret përkatëse të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit brenda një kornize indikative shumëvjeçare të bazuar në programe vjetore apo shumëvjeçare të caktuara nga BE-ja pas konsultimeve me Kosovën.

##### Neni 123

---

of 15 September 2021 establishing the Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA III)], e qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R1529&qid=1652771710674&from=en>.

<sup>4</sup> Po aty, nenet. 1-2. Objektivat e IPA III janë të listuara në Nenin 6 të Rregullorës (BE) 2021/1529. Lidhur me EU MFF 2021-2027, shih përmes: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:multiannual\\_financial\\_framework](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:multiannual_financial_framework).

<sup>5</sup> Shih nenet 2-3, shtojcat I dhe II të Rregullores (BE) 2021/1529.

Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së, zhvillimit socio-ekonomik, qeverisjes së mirë, reformës së administratës publike, energjisë dhe bujqësisë.

Neni 124

Me kërkesë të Kosovës dhe në raste me nevoja të veçanta, BE-ja, në koordinim me institucionet ndërkombëtare financiare mund të shqyrtojë mundësinë e dhënies së asistencës makro-financiare në baza të jashtëzakonshme e cila varet nga kushte të caktuara, duke marrë parasysh disponueshmërinë e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet pas përmbushjes së kushteve që do të vendosen në kontekstin e një programi për të cilin është arritur pajtimi në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Neni 125

Me qëllim që të mundësohet përdorimi sa më optimal i burimeve ekzistuese, Palët do të sigurohen që asistenca financiare e BE-së të jepet në bashkëpunim të ngushtë me atë nga burimet e tjera si ato prej shteteve anëtare, vendeve të tjera jashtë BE-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Kosova duhet rregullisht të ofrojë informata për të gjitha burimet e asistencës.<sup>6</sup>

## 7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA INSTITUCIONI I LINJËS

*Aspekti përmbajtësor dhe teknik*

Ky *Projektligj* bën ratifikimin e “Amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2016”. Nuk aplikohen TeP (Tabelat e Përputhshmërisë) me acquis të BE-së.

<sup>6</sup> *Shih* Ligjin Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, Gazeta Zyrtare: 34/2015 Data e publikimit: 01.12.2015, i qasshëm përmes: <https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?actid=11239>. Në kuadër të PKZMSA-së 2022-2026 (*programi për implementimin e MSA-së*), janë të përcaktuara aktivitetet që i referohen asistencës financiare që ndërlihen me IPA II dhe IPA III.

Të gjitha dokumentet e tjera janë dërguar dhe plotësuar pjesërisht sipas Manualit për Plotësimin e Tabelave të Përputhshmërisë dhe Deklaratës së Përputhshmërisë.<sup>7</sup>

#### 8. OPINIONI I PËRPUTHSHMËRISË

Ky Opinion i Përputhshmërisë është bazuar në përmbajtjen e draftit të projekt-aktit. Përgjegjësia e Divizionit për të Drejtën e BE-së në ZKM vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa institucioni propozues, është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP), atëherë kur projekt-akti ndërlidhet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishtëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projekt udhëzimit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës. *Manuali për Plotësimin e Tabelave dhe Deklaratës së Përputhshmërisë dhe Udhëzime Praktike për Përaftrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e Bashkimit Evropian*, përmbajnë udhëzime praktike për këtë proces.<sup>8</sup>

#### 9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Ky *Projektiligj* bën ratifikimin e “Amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2016”. Nuk aplikohet transpozimi i Rregullores (BE) 2021/1529, mirëpo, vendet përfituese nën këtë rregullore janë të obliguara të transpozojnë *acquis* të BE-së për realizimin e objektivave të IPA III sipas ligjeve dhe rregullave sektoriale vendore që kërkojnë transpozim sipas *acquis* përkatëse.<sup>9</sup>

Labinote Kashtanjeva



U.d. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së

Divizioni për të Drejtën e BE-së /Zyra e Kryeministrit

<sup>7</sup> E qasshme në: <http://mei-ks.net/sq/dokumente-udhzucese-mbi-procesin-e-prafrimit-ligjor>

<sup>8</sup> E qasshme përmes: <http://mei-ks.net/sq/dokumente-udhzucese-mbi-procesin-e-prafrimit-ligjor>

<sup>9</sup> Shih nëni 3 para. 1 i Rregullores (BE) 2021/1529.